



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BULQIZË
AUTORITETI KONTRAKTOR

Nr _____ prot

Bulqize më, ____ .09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje kancelari, tonera per fotokopje dhe printerash”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30192124-6,30197220-4,30197643-5, 30125120-8.

Loti 1: Blerje materiale kancelarie , me vlere fondi limit 751 458 (shtateqind e pesedhete e nje mije e katerqind e pesedhete e tete) leke pa tvsh

Loti 2; Blerje tonerash , me vlere fondi limit 665 208 (gjashteqind e gjashtedhete e pese mije e dyqind e tete) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Bulqize hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1: Blerje materiale kancelarie

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76 pika 1, 82 pika 1 dhe 83 pika 1 të LPP, ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. **Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim shtojca 7.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2 dhe 4, të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,.Përcaktimi 40 % të vlerës së Fondit Limit të kërkuar argumentohet me qëllim

vlerësimin e situatës ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë dhe rrjedhimisht të disponimit të kapaciteteve ekonomike dhe financiare për të realizuar me sukses kontratën dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, (nuk kane detyrime te prapambetura) në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin)

** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së, ndryshuar dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) citohet:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesa vetë legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

-ISO 9001- 2015 ose ekuivalente (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5/b si dhe nenit 44 , pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (nje) mjet transporti, për transportin e mallrave objekt prokurimi, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (çertifikate pronësie ose kontrate qeraje noteriale), leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit.

* *Kriteret për disponimin e mjetit do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së, ndryshuar. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e lartpërmendura. Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetin:

“ Kodi rrugor I Republikës së Shqipërisë” indryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se *“Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një lejeqarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”*

“ Kodi rugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se *“Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”*

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Përsigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: *“Pronari I çdomjeti transporti, përpara për dorimit të mjetit, është I detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti I transportit do të mbetet në qarkullim.”*

* *Kriteret për disponimin e mjetit do të konsiderohen të përmbushura gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e lartëpërmendura. Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetë deklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.*

Loti 1: Blerje tonerash

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a.. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8*
b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76 pika 1, 82 pika 1 dhe 83 pika 1 të LPP, ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim shtojca 7.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2 dhe 4, të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. c) *40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.* Përcaktimi 40 % të vlerës së Fondit Limit të kërkuar argumentohet me qëllim vlerësimin e situatës ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë dhe rrjedhimisht të disponimit të kapaciteteve ekonomike dhe financiare për të realizuar me sukses kontratën dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43, pika 2, germa ”c” të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, (nuk kanë detyrime të prapambetura) në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin)

* *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së, ndryshuar dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Bulqize, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujtuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 (i ndryshuar), shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

(Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) citohet:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesës vetë legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. b) *Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

-ISO 9001- 2015 ose ekuivalente (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5/b si dhe nenit 44 , pika 1,të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku citohet:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti, për transportin e mallrave objekt prokurimi, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronësie ose kontrate qeraje noteriale), leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit.

* *Kriteret për disponimin e mjetit do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së, ndryshuar. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e lartpërmendura. Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.*

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ndryshuar, dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të*

dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetin:

“ Kodi rrugor I Republikës së Shqipërisë” indryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një lejeqarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”

“ Kodi rugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Përsigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari I çdomjeti transporti, përpara për dorimit të mjetit, është I detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjete I transportit do të mbetet në qarkullim.”

* Kriteret për disponimin e mjetit do të konsiderohen të përmbushura gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e lartpërmendura. Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetë deklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të neni 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: *Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë fizikisht pranë Bashkisë Bulqize dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

*** Specifikimet teknike janë hartuar nga strukture e posaçme, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.**

Njesia e Prokurimit